



Projekti: Përforsimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

Shkup, 11.05.2017

Tryeza e pestë e rrumbullakët

Aspektet tatimore të likuidimit dhe fshirjes së subjeteve tregtare sipas detyrës zyrtare – probleme në praktikë

Në tryezën e pestë të rrumbullakët të mbajtur më 11 maj 2017, dedikuar likuidimit, u diskutua mbi „Aspektet tatimore të likuidimit dhe fshirjes së subjeteve tregtare sipas detyrës zyrtare – probleme në praktikë„. Përfaqësues të Ministrisë së ekonomisë, Ministrisë së financave, Drejtorisë së të ardhurave publike, Regjistrimit Qendror, Lidhjes së Odave ekonomike dhe Odës së përmbartuesve shpallorë qëndrimet dhe mendimet e tyre për mënyrën ekzistuese për rregullimin e detyrimeve tatimore, si në procesin e likuidimit për periudhën pas shpalljes nga Regjistri Qendror i RM-së deri në momentin e fshirjes nga Regjistri tregtar, ashtu edhe kur subjektet fshihen sipas detyrës zyrtare, për pasivitet të identifikuar afarist, në pajtim me nenin 477-a.

Ndërsa dispozitat ligjore që rregullojnë likuidimin përfshijnë obliime më të hollësishme për detyrimet tatimore dhe kushtet që duhet plotësuar, mospërputhja ligjore të fshirja e subjekteve sipas detyrës zyrtare paraqet bazë për evazion tatimor, dhe pronarët e këtyre shoqërive i vë në pozitë të lakmueshme të pakrahasueshme.



Në Drejtorinë e të ardhurave publike kontrollonhet (jo)aktiviteti i rreth 8000 subjekteve për periudhën 2012-2014 dhe për një pjesë të tyre, nga qershori i këtij vitit, do të propozohet hapje e falimentimit, dhe një pjesë do të fshihen nga Regjistri i vetëm tregtar.

Në diskutimin mbi pasojat e fshirjes së shoqërive tregtare sipas detyrës zyrtare, përfaqësues të Lidhjes së Odave ekonomike, si një ndër rrjetet më të mëdha afariste maqedonase, e cila përfaqëson intereset afariste të kompanive maqedonase, theksuan se ata janë iniciatorët e ndryshimeve ligjore për fshirjen, dhe se idea dhe qëllimi kanë qenë të shihet se cilat subjekte afariste vërtet punojnë. Numrat që ata kanë pasur, për rreth 35.000 deri 40.000 subjekte joaktive, tani po vërtetohen, edhe pse theksojnë duhej që të jenë pjesëmarrës në tërë procesin e ndryshimit të rregullativës ligjore, e jo vetëm gjatë inicimit.



Projekti „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare“ realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian ndërsa zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst&Young.